



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve

Nr. 3825/4 Prot.

Tiranë, më 5. 11. 2020

Lënda: Dërgohet Urdhëri i Ministrit nr. 317, datë 30.10.2020.

ALBPETROL SH.A

Patos

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për njohje dhe zbatim Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 317, datë 30.10.2020 “Për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për vendburimet ekzistuese “Povelçë” dhe “Frakull”.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Viola Haxhiademi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI**

Nr. 3825 / 13 Prot.

Tiranë, më 30.10.2020

URDHËR

Nr. 317, datë 30.10.2020

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIDHJEN E MARRËVESHJEVE
HIDROKARBURE PËR VENDBURIMET EKZISTUESE "POVELÇË" DHE
"FRAKULL".**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)", të ndryshuar, VKM nr. 335, datë 22.04.2015 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 279, datë 12.04.2012, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së objekteve të operacioneve hidrokarbure", pjesë e marrëveshjes së lidhur më 26.7.1993, ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetikës (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe Albpetrol, Bashkësisë Ekonomike të Naftës dhe Gazit (sot shoqëria "Albpetrol" Sh.a), të Urdhërit të Ministrit nr. 246, datë 12.03.2018 "Për miratimin e rregullores për percaktimin e procedurave të miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure, Licencë Marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse", si dhe për zbatimin e synimit themelor për thithjen e investimeve të huaja, apo vendase, në fushën e kërkimit, zhvillimit të naftës dhe gazit në territorin e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht për vendburimet ekzistuese, si dhe për të garantuar zhvillimin e një procedure të hapur, konkurruese,

URDHËROJ:

1. Albpetrol Sh.a. të pergatisë dokumentet për të ftuar subjektet e interesuara për të hyrë në Marrëveshje Hidrokarbure, sipas kërkesave të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)", të ndryshuar, për vendburimet ekzistuese "Povelçë" dhe "Frakull". Në këto dokumente të përfshihen formulari i aplikimit, harta me koordinatat për këto vendburime dhe të paraqiten në MIE për miratim.
2. Pas marrjes së miratimit nga MIE, Albpetrol Sh.A. të bëjë publikimin e tyre në faqen e saj të internetit. Pjesë e këtij publikimi duhet të jetë edhe vendosja e afatit të dorëzimit të

aplikimit nga kompanitë e interesuara për të lidhur Marrëveshje Hidrokarbure për vendburimet e ekzistuese “Povelçë” dhe “Frakull”, i cili duhet të jetë jo më pak se 90 ditë, duke filluar nga data e njoftimit.

3. Dokumentacioni që do të publikohet të dërgohet në mënyrë zyrtare në MIE dhe një kopje e tij të dërgohet në adresën elektronike të saj. MIE të publikojë në faqen e saj të internetit këtë dokumentacion.
4. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen Albpetrol Sh.a., si dhe Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve në MIE.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Belinda Balluku

